



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
Kuvendi i Komunës në Klinë

RREGULLORE
PËR
FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË ORGANIZATAVE
TË
BIZNESIT NË KOMUNËN E KLINËS

Klinë, tetor 2011

Në bazë të nenit 40 të Ligjit nr. 2004/18, për Tregtinë e Brendshme, si dhe në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 04/L-005 për Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, publikuar ne Fl. zyr. të Republikës së Kosovës nr. 5, pastaj duke pasur parasysh edhe dispozitat e Udhëzimit administrativ të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nr. 2007/03 për Fillimin dhe Mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe format tjera të organizmit të tregtisë, nenit 12 pika 12.2 nën (c), të Ligjit nr. 02/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, më pastaj frymës së dispozitave të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, e në mbështetje edhe të nenit 10 paragrafi 1 pika 3 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e vet të rregullt të IX me radhë, për vitin 2011, të mbajtur më 28.10.2011, miratoi:

R R E G U L L O R E
P Ë R
FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË ORGANIZATAVE
TË
BIZNESIT NË KOMUNËN E KLINËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe të aktiviteteve tjera: hoteleri, zejтари, prodhimtari dhe shërbime tjera të organizimit afarist dhe biznesor në territorin e Komunës së Klinës.

Përkufizimet

Neni 2

Përkufizimet dhe termat që përdoren në këtë Rregullore janë të përcaktuara dhe të qartësuara në dispozitën e nenit 2 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme, nr. 2004/18, si dhe nenit 1 të Ligjit nr. 04/L-005 për Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme.

Neni 3

Organizatat e biznesit dhe veprimtaritë tjera afariste, në pajtim me nenin 1 të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 4

4.1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore fillimin dhe mbarimin e punës.

4.2 Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duke përfshirë edhe kohën e pushimeve ditore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria e biznesit.

4.3. Në orar të punës duhet cekur ditët kur nuk punohet.

4.4. Për arsye të jashtëzakonshme, si dasma, vdekje, fatkeqësi të ndryshme etj., bizneset që nuk punojnë duhet që informacionin përkatës detal ta vënë në vend të dukshëm të firmës.

II. PERIUDHAT E ORARIT TË PUNËS

Neni 5

Orari i punës përcaktohet në bazë të llogaritjes verore dhe dimërore të kohës, në intervale kohore:

- a. periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator të vitit,
- b. periudha dimërore fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars të vitit.

III. ORARI I PUNËS SIPAS VEPRIMTARIVE AFARISTE-EKONOMIKE

1. Veprimtaritë e dyqaneve zejtare dhe shërbyese

Neni 6

6.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në dyqanet zejtare dhe ato shërbyese, do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 8:00 deri në orën 20:00,
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në orën 19:00.

6.2. Gjellëtoret dhe qebaptoret punojnë çdo ditë të javës:

- a. periudha verore, prej orës 6:00 - 22:00,
- b. periudha dimërore prej orës 7:00 - 21:00.

6.3. Ditën e fundjavës (të dielën) dyqanet zejtare nuk do të punojnë, përveç: gjellëtoreve, qebaptoreve, salloneve të ondulimit, floktoreve, autolarjeve dhe pikave të shitjes së shtypit ditor.

6.4. Pishinat gjatë periudhës verore punojnë nga ora 8:00 deri në ora 20:00, ndërkaq për zgjatjen e orarit të punës bëhet pagesa 10,00 euro për çdo orë të zgjatur të punës, sipas procedurës tek Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe lejes së veçantë të saj, si tek rastet e tjera të zgjatjes së orarit të punës.

6.5. Institucionet bankare, kompanitë e sigurimeve dhe agjencitë turistike fillojnë me punë në ora 8:00 deri në ora 17:00, ndërkaq ditëve të diela nuk punojnë.

6.6. Furrat e bukës punojnë çdo ditë në të dy sezonet, duke filluar prej orës 7:00 e deri në ora 23:00.

6.7. Nëse kërkohet orar më i zgjatur vepohet si në pikën 6.4 të këtij neni.

2. Qendrat tregtare, maketet, vetëshërbimet dhe dyqanet tjera tregtare ushqimore dhe jo ushqimore

Neni 7

7.1. Orari i punës në qendra tregtare, vetëshërbime, supermarkete, minimarkete dhe dyqane ushqimore, do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 7:00 – 23:00,
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 – 23:00.

7.2. Orari i punës në dyqanet tregtare të tekstilit, dyqanet e këpucave, libraritë, dyqanet e pajisjeve teknike shtëpiake “teknikës së bardhë” dhe veprimtarive të tjera jo ushqimore, do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 7:00 – 21:00,
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 - 20:00.

7.3. Përfundim nga pika 1 e këtij neni, do të ketë në atë se ditën e fundjavës (të dielën) nuk do të punohet.

3. Ndërmarrjet prodhuese dhe depot tjera

Neni 8

8.1. Orari i punës në depot e artikujve ushqimorë, depot e materialit ndërtimor, ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit, si dhe të ndërmarrjet tjera prodhuese, do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 8:00 - 20:00,
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 - 18:00.

8.2. Ditën e fundjavës (të dielën) dhe gjatë ditëve të festave, depot nuk punojnë.

8.3. Orari i punës në ndërmarrjet ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë), do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 7:00 - 18:00,
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 - 17:00.

8.4. Ndërmarrjet ndërtimore, në raste të jashtëzakonshme, për shkak të natyrës kontinuele të punëve, me leje të veçantë, të cilën e lëshon Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit - Resori i Ekonomisë, mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 23:00.

8.5. Pagesa është 10,00 euro për orë pune të zgjatur.

4. Veprimtaritë hoteliere: motelet, restorantet dhe kafenetë

Neni 9

- 9.1. Orari i punës në hotele, motele, restorante dhe kafene, do të jetë:
- a. periudha verore, prej orës 7:00 – 23:00,
 - b. periudha dimërore, prej orës 07:00 – 22:00.
- 9.2. Orari i punës në hotele, motele dhe restorante është i njëjtë në të dy sezonet dhe fillon prej orës: 7:00 - 24:00.
- 9.3. Përjashtim nga pika 2 e këtij neni do të ketë, sepse ato mund të punojnë më gjatë se orari i paraparë i punës, por jo më shumë se deri në orën 3:00 të mëngjesit, vetëm ditën e premte dhe të shtunë. Për këtë duhet të kërkohet leje e veçantë, të cilën e lëshon Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit - Resori i Ekonomisë.
- 9.4. Për vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksën shtesë, 10 € për orë pune shtesë.
- 9.5. Veprimtarive të lartpërmendura në piken 2 të këtij neni, nuk iu lejohet shërbimi për mysafirë jashtë objektit pas orës 24:00.

5. Veprimtaritë e kafe-bareve, disko-klubet, internet-kafet, fitneset dhe lojërat e fatit

Neni 10

- 10.1. Orari i punës në kafe - bare dhe disko-klube, është i njëjtë për të dy sezonet, fillon në orën 20:00 dhe mbaron në orën 3:00 (të mëngjesit).
- 10.2. Orari i punës për klubet e natës është i njëjtë në të dy sezonet, fillon prej orës 23:00 dhe mbaron në orën 5:00 (të mëngjesit).
- 10.3. Orari i punës për internet - kafe dhe bastore, kazino dhe lojërave të tjera të fatit, si dhe fitneset, fillon në orën 8:00 dhe mbaron në orën 23:00.

6. Stadiumet dhe palestrat sportive

Neni 11

Stadiumet e improvizuara të futbollit dhe palestrat sportive punojnë pa kufizime.

Neni 12

- 12.1 Veprimtarive të parapara në nenet 8, 9, 10 dhe 11 të kësaj Rregulloreje gjatë orarit të punës, nuk iu lejohet në çfarëdo forme, të prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohet veprimtaria.
- 12.2. Çështja e zhurmës përligjohet dhe sanksionohet me Ligjin për Mbrojtjen nga zhurma nr.02/L-102 (dispozita e nenit 25).

7. Veprimtaritë e tregjeve

Neni 13

13.1. Orari i punës për tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve është:

- a. periudha verore, prej orës 6:00 – 19:00,
- b. periudha dimërore, prej orës 7:00 – 18:00.

13.2. Tregu i gjelbër dhe ai i sendeve të tjera punon ditën e martë, ndërkaq nuk do të punojnë ditëve të festave, të përcaktuara më ligjin përkatës.

13.3. Tregu i kafshëve punon ditën e martë, ndërsa tregu i automjeteve po ashtu ditën e martë, ndërkaq edhe këto tregje nuk punojnë ditëve të festave.

Neni 14

Në objektet hoteliere, të cilat gjenden në afërsi deri në 100 m nga objektet e banimit, në të cilat organizohet program me muzikë të gjallë apo me audio - video mjete për reproduktimin e programit, programi nuk mund të vazhdojë pas orës 24 : 00.

8. Pikat e Shitjes së karburanteve

Neni 15

Orari i punës në pikat e shitjes së karburanteve është i njëjtë në të dy sezonet, dhe zgjatë 24 orë pandërprerë.

9. Veprimtaritë e barnatoreve, ordinancave dhe klinikave private

Neni 16

16.1. Orari i punës në barnatore, ordianca dhe klinika private do të jetë i njëjtë në të dy sezonet, fillon në orës 7:00 dhe mbaron në orën 22:00.

16.2. Në raste urgjente, të dielave dhe gjatë festave shtetërore, mund të punojnë edhe jashtë orarit të paraparë, nga paragrafit 16.1.

16.3. Barnaret që veprojnë në qytet, në harmoni me planin për kujdestari, të hartuar në bashkëveprim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Resorin e Ekonomisë, apo Zyrën tjetër kompetente të Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, do të kujdestarojnë 24 orë pandërprerë, sipas renditjes-rotacionit të hartuar në bashkëveprim me drejtoritë komunale kompetente.

Orari i punës gjatë festave zyrtare dhe shtetërore

Neni 17

17.1. Organizatat e biznesit mund të punojnë dhe ta zgjasin orarin e punës, deri në orën 1:00 (të mëngjesit), me rastin e festave të parapara me Ligjin për Festat zyrtare nr. 03/L-064.

17.2. Për të gjitha rastet e parapara në pikën 1 të këtij neni, nuk paguhet taksa shtesë.

Neni 18

18.1. Në raste të veçanta nga dispozitat e kësaj Rregulloreje, e me kërkesë të subjekteve biznesore dhe me miratim e vendim të veçantë të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, mund të përcaktohet orari tjetër i punës apo edhe orari 24 orë pandërprerë i punës.

18.2. Vendimi nga al.1 e këtij neni do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

18.3. Rastet e kujdestarisë së punës të subjekteve biznesore përcaktohen me vendim të veçantë të organit nga neni 18 pika 18.1 të kësaj Rregulloreje.

IV. DISPOZITAT NDËSHKUESE

a) Masat administrative

Neni 19

19.1. Masat administrative i shqipton dhe ndërmerr Inspekcioni i tregut apo inspektori tjetër i autorizuar në kuadër të drejtorisë kompetente komunale.

19.2. Nëse inspektori kompetent, ose ai i autorizuar gjatë inspektimit konstaton që personi nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 38 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme dhe nenit 5 të Ligjit për Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Tregtinë e Brendshme, ose nëse tregtari nuk e respekton orarin e caktuar të punës të paraparë me nenin 40 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme, si dhe me nenet 6 deri në nenin 16 të kësaj Rregulloreje, ndaj tij do të veprohet dhe merren masat përkatëse në pajtim me nenin 9 dhe 10 të Ligjit për Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Tregtinë e Brendshme, duke marr vendim për ndalimin e afarizmit.

b) Masat ndëshkuese kundërvajtëse dhe masat mbrojtëse

Neni 20

20.1. Procedurën kundërvajtëse e inicion inspektori kompetent komunal, i tregut apo inspektori tjetër i autorizuar, ndërkaq që procedura udhëhiqet nga gjykata kompetente në kuptim më nenin 63 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme.

20.2. Të gjitha organizatat e biznesit do të gjobiten për kundërvajtje, dhe ndërmerren masat përkatëse mbrojtëse sipas procedurës së iniciuar nga inspektori kompetent, në qoftë se bizneset veprojnë në kundërshtim me nenet 60, 61 dhe 62 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme nr.2004/18, si dhe në kundërshtim me nenet 11 dhe 12 të Ligjit për Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Tregtinë e Brendshme nr.04/L-005 publikuar në Fletoren zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 5 të dt. 21.07.2011.

Neni 21

Të gjitha organizatat e biznesit të cilat marrin leje të veçantë për orar të zgjatur të punës, nëse nuk e përfillin kodin afarist dhe rrezikojnë sigurinë e qytetarëve, do t'u merret leja e punës e lëshuar nga Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit- Resori kompetent i Ekonomisë.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 22

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset: Drejtoria e Inspektoratit-Inspekcioni kompetent i tregut, Inspekcioni sanitar, e po ashtu edhe Inspekcioni i punës, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe resorët kompetentë të saj, Policia, dhe Gjykata për Kundërvajtje.

Neni 23

Të gjitha organizatat e biznesit janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje, në afatin tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes së kësaj Rregulloreje në fuqi.

Neni 24

Nëse ndonjë veprimtari, ose çështje lidhur me caktimin e orarit të punës nuk është e përfshirë me këtë Rregullore ose në rast të ndonjë zbrazëtirë tjetër juridike, do të vlejnë dhe do të zbatohen drejtpërsëdrejti dispozitat përkatëse të Ligjit për Tregtinë e Brendshme së bashku me ndryshimet e tij, ligjeve të tjera që përligojnë çështjen e orarit të punës se bizneseve dhe afarizmit, si dhe dispozitat e Udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 25

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja nr. 01-313-337/2003, e dt. 01.10.2003 për Caktimin e orarit të punës së subjekteve ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë afariste në territorin e Komunës së Klinës.

Neni 26

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË KLINË

01 Nr. - 06-4095 /2011
Klinë, me dt. 03.11 2011



Kryesuesi,
Fadil Gashi